



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.51/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesat e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat me numër të lendes A nr. 51 dhe A nr. 60 të organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar dy ankesa me datë 10.01.2011, nga BIRN-i në të cilat theksohet se:

A nr. 51- me datën 09.01.2011 në afërsi prej 100m të QV 0105C ne shkollën fillore “Bajram Curri” qytetareve ju është shpërndarë kartela me numrin e subjektit politik PDK dhe numrat e kandidateve , me të cilën udhëzoheshin për ke të votonin. Parashtruesi i ankesës thekson se nga dëshmitarët e rastit është dëgjuar se së bashku me këtë kartele janë dhënë edhe të holla (100 euro) për personat të cilët pranonin të votonin sipas kësaj kartele. Këto kartela janë shpërndarë edhe ne Fast Food “Express”. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotokopje të fotos se kartelës.

A nr. 60- me datën 09.01.2011 në afërsi prej 100m të QV 0105C ne shkollën fillore “Bajram Curri” është shpërndarë material propagandues. Ky material sipas parashtruesit të ankesës është shpërndarë edhe ne Fast Food “Express”. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotokopje të fotos se kartelës.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) dhe neni 6 paragrafi 3 parashohin si vijon:

*3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

*6.3 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim- marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë.*

PZAP-i vlerësoi se kemi te bëjmë me dy raste të njëjta dhe pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesave janë të pabazuara për shkakun se nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar. Për më tepër fotokopja e fotos se kartelës nuk e ka bere te mundur qe te verifikohet shpërndarja e materialit propangadues te subjektit politik PDK në afërsi prej 100m të QV 0105C ne shkollën fillore “Bajram Curri”. Po ashtu nëpërmjet kësaj fotoje nuk mund te verifikohet se janë dhënë te holla (100 euro) për personat te cilët pranonin te votonin sipas kësaj kartele. PZAP-i duke u bazuar në këto arsye e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 51/2011 më datën 13.01.2011.

